



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

*M. 3968/mot
dt. 16.04.2018*

UDHËZIM

Nr. 15, datë 16.04 2018

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 03.08.2016 "PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË VENDIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të 91 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr. 17, datë 03.08.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit", i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën "b", të pikës 1, të Kreut III termi "Diplomën¹" të bëhet "Diplomën".
2. Në Kreun II dhe në pikën 1 të Kreut III, shprehjet "Ministria e Arsimit dhe Sportit" dhe "MAS" të zëvendësohen me "Qendra e Shërbimeve Arsimore" dhe "QSHA".
3. Në pikën 1 të kreut IV, fjalia e fundit "*Aplikimi nuk konsiderohet i plotë nëse formulari i aplikimit nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara me detyrim aty. Në këto raste dosja arkivohet dhe aplikanti njoftohet me e-mail*", të ndryshohet si më poshtë:

"Në rast të mangësive në dokumentacion, aplikantit i kërkohet fillimisht plotësim dokumentacioni me anë të postës elektronike, brenda 15 ditëve nga momenti i depozitimit të aplikimit në QSHA. Në rast të mos depozitimit të plotësimeve brenda katër javëve, aplikantit i kërkohen plotësime për herë të dytë me shkresë zyrtare, të cilat duhet të depozitohen brenda katër javëve në QSHA, në të kundërt praktika depozitohet në arkivën e QSHA-së dhe aplikanti duhet të bëjë aplikim nga fillimi."

